



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin shkurt 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Si Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin mbi punën e kryer gjatë muajit shkurt 2019 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Gjatë këtij muaji jemi takuar me një numër të konsiderueshëm aktorësh dhe faktorësh në treg, me të cilët jemi përpjekur të ndajmë eksperiencat me ta. Nga vizitat në disa sipërmarrje në qytete të ndryshme kemi patur një mori eksperiencash pozitive të cilat duam ti promovojmë akoma edhe më tej. Por ndërkohë kemi reaguar në mënyrë të menjëhershme përsa u përket eksperiencave jo të mira me të cilat sipërmarrja përballet në përditshmërinë e saj dhe për disa prej tyre janë mundësuar zgjidhje të shpejta dhe efikase. Ndërsa për çështje të cilat kanë nevojë për zgjidhje të qëndrueshme kemi intensifikuar bashkëpunimin me institucionet përkatëse për të ndërtuar praktika të mira si dhe strategji afatshkurta dhe afatmesme.

Për t'ju ardhur në ndihmë në mënyrë sa më të qënësishme dhe koherente kemi ngritur Këshillin Strategjik pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me pjesëmarrjen e personaliteteteve nga fusha të ndryshme të biznesit, partnerëve ndërkombëtarë, si dhe të botës akademike në vendin tonë.

Zhvillimi i Samitit të Diasporës na mundësoi vendosjen e kontakteve shumë të vlefshme me sipërmarrësit shqiptarë nëpër botë, me të cilët shpresojmë shumë që nëpërmjet urave të komunikimit të lehtësojmë aksesimin e tregut shqiptar prej tyre, duke bërë të mundur

thjeshtimin e procedurave me qëllim eliminimin e barrierave burokratike të administratës publike.

Në muajin shkurt janë realizuar disa takime me shoqatat e biznesit, konkretisht me Shoqatën e Prodhuesve Shqiptarë si dhe Shoqatën e Industrialistëve Ushqimorë, të cilët kanë patur ndikime në sipërmarrjet e tyre nga ndryshimet e paketës fiskale 2019, si dhe kemi përcjellur dhe argumentuar të gjitha shqetësimet e tyre pranë institucioneve përkatëse të cilat merren me hartimin dhe ndryshimin e politikave fiskale.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe takimet me Shoqatën e Siguruesve Shqiptarë si dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave me të cilët kemi patur diskutime konstruktive për të lehtësuar procedurat si dhe për të forcuar bashkëpunimin me ta me qëllim krijimin e një klime sa më të mirë për gjithë sipërmarrjen në vendin tonë.

Duke shprehur në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,
Eduard Shalsi

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Agjensia Kombëtare e Mjedisit	16.01.2019	Subjekti kërkon asistencë ndërinstitucionale për mundësimin e marrjes së lejes mjedisore.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.2	Inspektoriati i Mjedisit	01.02.2019	Subjekti kërkon asistencë për pajisjen me lejen mjedisore dhe përgjigje ndaj kërkesës online.	Në proces
Nr.3	Bashkia Tirane	06.02.2019	Subjekti pretendon shkelje procedure nga ana e punonjësve të Bashkisë përsa i përket pagesave në bankë.	Në proces
Nr.4	Bashkia Maliq	07.02.2019	Subjekti kërkon rishikimin e kontratës bazuar në VKM-në 54/2014.	Në proces
Nr.5	Qendra Kombtare e Edukimit në Vazhdim	09.02.2019	Refuzim i kërkeses për akreditimin e një kursi profesional.	Në proces
Nr.6	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave & Agjensia Kombëtare e Ushqimit	11.02.2019	Subjekti kërkon mbrojtjen e të drejtës së ekskluzivitetit si dhe mosçenimin e sigurisë ushqimore.	Në proces
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.02.2019	Subjekti kërkon ndryshim ligjor në lidhje me taksën e ambalazhit për produktet e polisterolit.	Në proces
Nr.8	Drejtorja Përgjithshme Tatimore	13.02.2019	Subjekti ka kërkuar rimbursimin e TVSH-së por nuk ka marrë përgjigje.	Në proces
Nr.9	Agjensia Kombëtare e Turizmit	13.02.2019	Subjekti kërkon likuidim të detyrimeve kontraktuale nga AKT.	Në proces
Nr.10	Bashkia - Qarku Korce	15.02.2019	Subjekti kërkon asistencë financiare për fonde nga ana e institucioneve publike për të hapur një veprimtari biznesi.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.11	Enti Rregullator i Ujit	19.02.2019	Subjekti kërkon mosfaturimin e sasisë së ujit nga një njësi administrative vendore drejt një njësie administrative tjetër.	Në proces
Nr.12	Inspektoriati i Mjedisit	19.02.2019	Subjekti kërkon zgjidhje për gjobën e vendosur nga Inspektoriati i Mjedisit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.13	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	20.02.2019	Subjekti kërkon Zbardhien e projektit të Ndërtimit të Centralit Elektrik Fotovoltaik në përputhje me autorizimin për prodhim energjie elektrike.	Trajtuar me përgjigje
Nr.14	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	20.02.2019	Subjekti kërkon të marrë pjesë në tenderat që organizon MIE por nuk e pranon sistemi online, duke qënë se jeton jashtë Shqipërisë.	Në proces
Nr.15	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	20.02.2019	Individi ka kryer përditësimin e kasës fiskale, dhe i kërkohet të bëhet pagesa për 2 vjet, ndërkohë që individi nuk ka mundësi për të kryer pagesën e plotë për të dy vitet.	Në proces
Nr.16	Bashkia - Qarku Fier	20.02.2019	Subjekti kërkon shëmbjen e nje garazhi para ndërtesës ku ndodhen zyrat e subjektit.	Në proces
Nr.17	Bashkia - Qarku Vlorë	20.02.2019	Individi ankohet që problematika e tij nuk është zgjidhur akoma, nuk ka asnjë dokument apo letër ankesë bashkëlidhur.	Në proces
Nr.18	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	20.02.2019	Subjekti ankohet në lidhje me gjobat e papaguara të një biznesi që ka falimentuar dhe është mbyllur në 2014. Subjekti nuk mund të hapë një biznes të ri për shkak të gjobave të prapambetura.	Në proces
Nr.19	Bashkia -Qarku Korçë	20.02.2019	Subjekti ankohet pasi bashkia nuk e lojon që të vendosi një tende ndërkohë që të gjithë bizneset rreth e rrotull e kanë të drejtën.	Në proces
Nr.20	Ministria e Drejtësisë	20.02.2019	Subjekti kërkon bashkëpunim për pajisjen me titull të pronësisë mbi tokës sipas lejes së legalizimit dhe te certifikatës së pronësisë , si dhe dretim mbi procesin e pajisjes me lejet e ndërtimit për dy kapanon të tjerë.	Në proces

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.21	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.	20.02.2019	Subjekti kërkon rishikimin e procedurave që duhet të ndjek një biznes në lidhje me inspektoriatin e punës si dhe listën e dokumenteve të detyrueshëm që duhet të mbajnë subjektet.	Në proces
Nr.22	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	20.02.2019	Ankesë në lidhje me mbrojtjen e bizneseve si the kostot për mallrat e importit.	Trajtuar me përgjigje
Nr.23	Komisioni i Prokurimit Publik	20.02.2019	Subjekti ka paraqitur ankesë në lidhje me tenderin e pastrimit me Bashkinë Korçë.	Trajtuar me përgjigje
Nr.24	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	21.02.2019	Subjekti ka paraqitur ankesë për vendosjen e gjobës në mënyrë të padrejtë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.25	Autoriteti i Verifikimit Ushqimor Kosovë	22.02.2019	Subjekti ka paraqitur ankesë në lidhje me certifikatën e origjinës së mallrave.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.26	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	24.02.2019	Subjekti ka paraqitur ankesë për aplikimin e referencës nga Dega e Doganës Tiranë.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.27	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	26.02.2019	Subjekti ka paraqitur ankesë për vendosjen e gjobës në mënyrë të padrejtë nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.28	Agjensia e Prokurimit Publik	26.02.2019	Subjekti ka paraqitur ankesë për tenderin e evadimit të mbetjeve për Spitalin Shtetëror.	Trajtuar me përgjigje
Nr.29	Ministria e Bujqësisë	28.02.2019	Subjekti kërkon përfshirjen e dy inputeve bujqësore në VKM-në që përfitojnë nga perjashtimi nga TVSH-ja e inputeve bujqësore.	Në proces
Nr.30	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	28.02.2019	Subjekti kërkon aplikimin e regjimit doganor.	Trajtuar me përgjigje

Nr.	Instucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.31	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave & Ministria e Financave dhe Ekonomisë	01.03.2019	Subjekti pretendon se ka pasur veprime arbitrare nga dogana në lidhje me rivleresimin e deklaratave doganore	Në proces

